

KONTRATA SOCIALE TIRANË

RAPORT MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE SHTATOR 2020-SHTATOR 2021

Viti i II-të i monitorimit

PËRGATITUR NGA:
QENDRA "ALEANCA GJINORE PËR ZHVILLIM"

POP – PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE

Shtator 2020 – Shtator 2021

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: “Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social” dhe National Endowment for Democracy.

Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

Qendra “Aleanca Gjinore per Zhvillim”, Tiranë;
Qendra "Për Zhvillimin e Shoqërisë Civile", Durrës;
"Qendra Rinore" Vlorë;
"Shoqata për Integrimin e Zonave Informale", Kamëz;
Qendra "Epoka e Re", Fier;
"Intelektualët e Rinj Shpresë", Shkodër;
"Lëvizja Rinore për Demokraci", Pukë;
"Qendra Rinore për Progres", Kukës;
"Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim", Progradec;
"Hapa të Lehtë", Vau i Dejës;
"Tjetër Vizion", Elbasan;
"Gruaja në Zhvillim", Korçë.

Ky Raport është Përgatitur nga Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” në kuadër të projektit POP 2021 “Kontrata Sociale, mjet për të forcuar marrëdhëniet mes qytetareve dhe pushtetarëve” dhe nuk përfaqëson qëndrimin e Olof Palme International Center dhe National Endowment for Democracy. Gjetjet dhe qëndrimet në raport janë përgjegjësi vetëm e autorëve.

Tabela Përmbledhëse

SHKURTIME	4
FALENDERIME	5
HYRJE	6
METODOLOGJIA	7
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	8
GJETJE NGA INFORMACIONI I MBLEDHUR NË LIDHJE ME 11 PRIORITETET E KONTRATËS SOCIALE – VITI I DYTË I MONITORIMIT SHTATOR 2020 – SHTATOR 2021:	8
ANALIZA E GJETJEVE PËR SECILIN PRIORITET SIPAS KONTRATËS SOCIALE	11
PRIORITETI NR. 1:	11
PRIORITETI NR. 2:	11
PRIORITETI NR. 3:	12
PRIORITETI NR. 4:	13
PRIORITETI NR. 5:	13
PRIORITETI NR. 6:	14
PRIORITETI NR. 7:	16
PRIORITETI NR. 8:	17
PRIORITETI NR. 9:	17
PRIORITETI NR.10:	20
PRIORITETI NR. 11:	21
GJETJET NGA FOKUS-GRUPET ME KOMUNITETIN TIRANË.....	21
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	27
REFERENCA	28
ANEKSE	29
<i>Aneks 1. Kontrata Sociale e detajuar</i>	29
<i>Aneks 2 – Gjetjet Kryesore të Raportit të Vitit të Parë Monitorues</i>	31
<i>Aneks 3 – Investimet në shkolla</i>	33

Shkurtime

NE	Ndihmë Ekonomike
NJA	Njësi Administrative
URB	Zonat Urbane
RUR	Zonat Rurale
GADC	Qendra “Aleanca Gjimore për Zhvillimi”
OJF	Organizata Jo Fitimprurëse
KB	Këshilli Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
PAK	Personat me aftësi të kufizuar
POP	Përballja e Ofertave Politike
MKR	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
BTF	Bashki të Forta
COVID - 19	Pandemia e Virusit Korona
Kontrata Sociale	11 prioritetet kryesore të identifikuara nga qytetarët gjatë 2019
AZHRB	Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural
UKT	Ujësjellës Kanalizime Tiranë

Falenderime

Për të hartuar këtë Raportin e vitit të dytë të monitorimit të Kontratës Sociale, bashkëpunuam me shumë aktorë e institucione. Falenderojmë Bashkinë Tiranë dhe drejtoritë përkatëse, për vënien në dispozicion të informacioneve të kërkuara; Kryetarin e Bashkisë z. Erion Veliaj dhe Nënkryetaren znj. Anisa Ruseti për disponibilitetin e tyre në komunikimet e vazhdueshme përgjatë dy viteve të monitorimit të Kontratës Sociale të Tiranës.

Falenderojmë në mënyrë të veçantë qytetarët që pranuan t'i përgjigjeshin pyetjeve tona, anëtarët e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP) si edhe një falenderim për stafin dhe vullnetarët e Qendrës “Aleanca Gjimore për Zhvillim”, të cilët që prej momentit të nënshkrimit të Kontratës Sociale kanë qenë në monitorim të vazhdueshëm të punës së Bashkisë Tiranë dhe vendimeve të Këshillit Bashkiak.

Gjithashtu, dëshirojmë të falenderojmë **Olof Palme International Center** dhe **NED – National Endowment for Democracy** për ndihmën teknike e financiare, pa të cilët do të ishte e pamundur të hartohesh ky raport dhe të realizoheshin aktivitete të ndryshme nga Rrjeti POP.

Hyrje

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët, si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioritetëve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë vendore, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Gjatë vitit 2019 janë hartuar kontratat sociale për 9 bashki (Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Kamëz, Pogradec dhe Pukë), ndërsa tre bashki të reja u bënë pjesë e këtij procesi në vitin 2021, përmes replikimit të procesit edhe në bashkitë e Elbasanit, Vau i Dejës dhe Korçë. Gjatë periudhës shtator 2020-2021, rrjeti POP monitoroi zbatimin e tyre përmes dy projekteve që shkrihen te njëri – tjetri të financuara nga Olof Plame International Centre (OPIC) dhe National Endowment for Democracy (NED).

Kontrata Sociale në Tiranë¹ përmban 11 prioritete që qytetarët e Tiranës identifikuan në zgjedhjet lokale të 2019. Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” (GADC), synoi të krijojë dhe promovojë mekanizma qytetarë në funksion të përmirësimit të demokracisë lokale, duke angazhuar qytetarët, partitë politike, kandidatët për deputetë në zgjedhjet parlamentare të 2021, stafin e Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak të dialogojnë dhe të punojnë për realizimin e prioritetëve të Kontratës Sociale. GADC mundësoi vlerësimin dhe monitorimin e performancës së administratës lokale dhe të zgjedhurve vendorë duke promovuar dialog dhe bashkëpunim në nivel vendor. Në Bashkinë Tiranë, Kontrata Sociale bëri që komuniteti të ketë një mjet për të mbajtur stafin e bashkisë dhe Këshillin e Bashkiak përgjegjës për adresimin e tyre, por duke përdorur edhe zgjedhjet parlamentare të 2021, advokoi me të gjitha partitë politike dhe kandidatët e tyre për të futur në agjendat politike edhe prioritetet e Kontratës Sociale.

Në vitin e parë të monitorimit të kontratës sociale për bashkinë Tiranë, 70 % e prioritetëve të qytetarëve u përmbushën duke i hapur rrugë kështu rivlerësimit nga ana e Bashkisë edhe të prioritetëve të tjera të dala nga takimet periodike mes komunitetit dhe Qendrës “Aleanca Gjinore për Zhvillim”.

Raporti² i vitit të parë monitorues u prezantua³ pranë sallës së Këshillit Bashkiak Tiranë me pjesëmarrjen e drejtuesve të drejtorive përkatëse përgjegjëse për përmbushjen e nevojave të qytetarëve dhe me Nënkryetaren e Bashkisë znj. Anisa Ruseti.

Gjatë vitit 2021, projekti vazhdoi me “Kontrata Sociale si një mjet për të forcuar marrëdhëniet mes qytetareve dhe pushtetarëve”, duke vijuar monitorimin dhe bashkëpunimin mes aktorëve kryesorë për përmbushjen e prioritetëve të qytetarëve.

¹ Kontrata Sociale me bashkinë Tiranë: <https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2020/07/Tirana-Prioritetet-A3-Kontrata.pdf>

² Raporti I vitit të parë monitorues: https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2020/11/Raporti_POP_Bashkia_Tirane.pdf

³ Prezantimi I raportit monitorues: <https://popnetwork.al/prezantimi-i-raportit-nje-vjecar-kontrata-sociale-pop-bashkia-tirane/>

Ky raport vlerëson progresin e bërë në realizimin e prioritetëve të Kontratës Sociale për periudhën Shtator 2020 – Shtator 2021.

Gjatë vitit të dytë të monitorimit Organizata kishte si qëllim:

- Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e Bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të adresimit të prioritetëve të Kontratës Sociale;
- Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e Bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të fatkeqësisë natyrore për shkak të pandemisë;
- Të raportojë gjetjet dhe rekomandimet;
- Të llobojë dhe advokojë për përmbushjen e prioritetëve të qytetarëve, sidomos në kuadër të dimensionit social, transparencës dhe llogaridhënies.
- Organizimin e debateve politike dhe publike mes kandidatëve për anëtarë të parlamentit përpara zgjedhjeve të 25 Prillit 2021. Debate këto, që kishin si qëllim Kontratën Sociale, si një dokument me prioritetet e përzgjedhura nga komuniteti i Tiranës, si edhe dëgjesa e programeve të subjekteve politike në raport me këto prioritete, bazuar në shtyllat kryesore: Shëndetësia; Zhvillimi Ekonomik; Infrastruktura Publike; Pjesëmarrja Qytetare dhe Transparenca.
- Angazhimin e grupeve qytetare në fushata advokimi dhe lobimi për përmbushjen e prioritetëve të Kontratës Sociale.

Metodologjia

Për të realizuar raportin, GADC, anëtare e rrjetit POP u bazua në hapat e mëposhtëm:

- U monitorua puna e Bashkisë Tiranë dhe vendimet e Këshillit Bashkiak për periudhën Shtator 2020 – Shtator 2021;
- U dërgua një letër-kërkesë me email për informacion, drejtuesve të Drejtorive dhe Departamenteve përkatëse, sipas prioritetëve të Kontratës Sociale.
- U organizuan takime me Nënkryetaren e Bashkisë znj. Anisa Ruseti, Administratorë të Njësive Administrative dhe qytetarë të Tiranës, mbi ecurinë e punës sa i përket përmbushjes së prioritetëve të komunitetit të Tiranës;
- U realizuan fokus-grupe me anëtarë të komunitetit në 10 Njësi Administrative të Tiranës, me pjesëmarrës të cilët kanë qenë pjesë e aktiviteteve të mëparshme dhe kanë kontribuar në përcaktimin e prioritetëve të Kontratës Sociale si edhe në monitorimin e saj gjatë vitit të parë.
- U monitorua në vazhdim puna e Këshillit Bashkiak Tiranë, mbledhjet e organizuara gjatë pandemisë si edhe mbledhjet në vend.
- U monitoruan vendimet e Këshillit të Bashkisë Tiranë.
- U realizuan disa takime me drejtues të Shërbimit të Mbrojtjes Sociale pranë kësaj Bashkie, specifikisht me Drejtoreshën e Përgjithshme znj. Anisa Subashi;

- U monitoruan takimet e ndryshme të përfaqësuesve të Bashkisë përmes TV dhe medias sociale.
- U monitoruan vendimet e Këshillit Bashkiak mbi masat e marra nga vetë Bashkia, në lidhje me komunitetin në përgjithësi dhe me disa target-grupe në veçanti, si dhe veprimtaria e anëtarëve të Këshillit Bashkiak.
- U analizua dhe monitorua buxheti i bashkisë për vitit 2020 – 2021 si dhe shpenzimet respektive bazuar në open-data;
- U monitoruan dhe analizuan vendimet e KB që kanë lidhje me prioritetet e Kontratës Sociale bazuar në punën e rrjetit POP apo edhe nga faktorë të tjerë të jashtëm, të tipit: parashikime të mëhershme në buxhet, plane afatshkurtra apo/dhe afatgjata, puna e organizatave të tjera të cilat mund të kenë ndikuar në përmbushje (organizata qeveritare, organizata ndërkombëtare me projekte apo edhe kombëtare).
- Analizimi i monitorimit të mediave audiovizive dhe on line, në lidhje me sa më sipër sipas fushave specifike.

Përmbledhje ekzekutive

Në bazë të monitorimit të Bashkisë Tiranë, të kryer nga Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” më poshtë renditen disa nga gjetjet kryesore të dala nga ky monitorim.

Gjetje nga informacioni i mbledhur në lidhje me 11 prioritetet e Kontratës Sociale – Viti i dytë i monitorimit Shtator 2020 – Shtator 2021:

- Me Vendimin e ri **nr. 475, datë 31.7.2021**, veterinerët zyrtarë janë nën varësinë e Agjencisë Rajonale të Shërbimit Veterinar, në varësi të Ministrisë së Bujqësisë. Bashkia Tiranë kryen vetëm monitorim të profilaksisë në bashkëpunim me strukturat e shërbimit veterinar rajonal.
- Në lidhje me nxitjen e biznesit tek të rinjtë, gratë dhe grupet vulnerabël, ka patur rritje, mbështetje dhe bashkim projektësh. Projekti “Fuqizimi i të rinjve dhe të rejave” ka ardhur si rrjedhojë e bashkimit të dy projekteve: “Të rinjtë dhe të rejat drejt një profesioni” me buxhet 5.000.000 Lekë dhe projektit “Biznesi Rinor” me buxhet 10.000.000 Lekë. **Thirrja për këtë vit u shpall nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale**, nëpërmjet Drejtorisë së Nxitjes së Punësimit. Ndërkohë që, nuk ka rritje në numrin e përfituesve krahasuar me një vit më parë.
- Sipas monitorimit të kryer nga Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” gjatë vitit 2021, Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural ka mbyllur thirrjen për aplikim në datë 25 Janar 2021 për fondet e programit IPARD 2, me një shumë financimi prej **30 mln Euro me 360 aplikime** në total. Ndërkohë, sa i përket Skemës Kombëtare për mbështetje financiare për bujqësinë dhe zhvillimin rural nga buxheti i qeverisë shqiptare, **gjatë vitit 2021 ishin 54 përfitues** në total, ndryshe nga një vit më parë ku numri i përfituesve ishte **94**.

- Sa i përket taksave bashkiake, krijimi i lehtësive për kategoritë në nevojë si gra kryefamiljare, invalidë të punës, persona me aftësi ndryshe, vajza-nëna, mbetet njësoj si një vit më parë pa ndonjë lehtësi të dukshme. Sipas banorëve, janë hequr taksat vendore për kategoritë në nevojë (taksat e përfshira në faturën e ujit), ndërsa personat me aftësi të kufizuar dhe invalidët e punës, përfitojnë nga heqja e taksës vetëm nëse familjarët e tyre janë të papunë.
- Çerdhet dhe kopshtet e fëmijëve, edhe këtë vit kanë marrë një vëmendje të veçantë nga Bashkia Tiranë, duke hapur dyert e **8 çerdheve dhe kopshteve** në të gjithë territorin e bashkisë. Gjithashtu, këtë vit në **Njësinë Administrative Dajt** është hapur shërbim i ri i çerdhes dhe i kopshtit me kapacitet **200 fëmijë**.
- Bashkia Tiranë njësoj si një vit më parë vijon me ofrimin e shërbimit rezidencial për të moshuar dhe persona që jetojnë në situatë rruge, target-grup i vlerësuar si më vulnerabël, **përmes Qendrës Sociale “Strehëza Tiranë”**
- Në bashkinë e Tiranës aktualisht po zbatohen **2 projekte për të moshuarit** në bashkëpunim me OSHC-të, projekti me titull: “Nuk je vetëm!” (Asistencë shtëpiake për të moshuarit në nevojë), nga ku do të jenë përfitues **35 të moshuar** dhe projekti me titull: “Shërbimi multidisiplinar në banesë për të moshuarit në nevojë dhe të vetmuar, në bashkinë Tiranë“, ku ka përfitues edhe nga Njësitë Administrative Dajt, Zall-Herr, Sauk, Baldushk, Ndroq, Kashar, Farkë, Selitë, Vaqarr.
- Gjatë periudhës Janar – Shtator 2021 numri total i aplikimeve të programit social "Subvencionimi i qirasë" për kategoritë e kryefamiljareve me fëmijë, vajza-nëna/gra të dhunuara me Urdhër Mbrojtje apo gra të divorcuara, ishte 144 aplikime. **Numri i përfituesve nga ky program social është 69.**
- Në përmbushje të funksioneve të njëjësive të vetqeverisjes vendore në qendrat komunitare të Bashkisë Tiranë si “Të Qëndrojmë së Bashku”, “Gonxhe Bojaxhi”, “Qendra Komunitare Multidisiplinare” dhe “Qendra Komunitare Shkozë”, **është rritur numri i përfituesve** për shkak të rritjes së kohëzgjatjes të shërbimit ditor përgjatë gjithë ditëve të javës, pra, shërbime 08:00 – 20:00 nga e hëna në të premte dhe të shtunën 09:00-14:00.
- Përgjatë periudhës Shtator 2020- Shtator 2021, janë miratuar **11 Vendime të Këshillit Bashkiak me 319 përfitues të "Subvencionimit të qirasë" dhe 1 Vendim i Këshillit Bashkiak me 806 përfitues të “Subvencionimit të interesave të kredisë”**. Ndër to janë shpallur përfituese (të dy programeve së bashku) **566 gra, nga të cilat 5 janë të mbijetuara të dhunës në familje.**
- Gjatë vitit të parë monitorues Bashkia e Tiranës realizoi ndërhyrje dhe rikonstrukcion në **12 shkolla në territorin** e saj, ku u përfshinë Njësitë Administrative Baldushk; Dajt; 1, 2, 3, 5 dhe 8. Gjatë periudhës së monitorimit Shtator 2020 – Shtator 2021 dhe bazuar në monitorimin e GADC-së dhe në informacionin e marrë nga Bashkia Tiranë, janë **rindërtuar 6 shkolla**. Gjithashtu, janë ndërtuar nga e para dhe kanë hapur dyert për nxënësit në Shtator **2021 edhe 2 shkolla** të tjera. Ndërkohë që, aktualisht Bashkia Tiranë ka planifikuar edhe ndërtimin e **4 shkollave** të tjera, të cilat do të jenë gati dhe funksionale brenda vitit **2022**.

- Ndërkohë, gjatë vitit 2021 në kuadër të projektit "Bibliotekat e lagjeve si qendra multifunktionale", Bashkia Tiranë ka inauguruar hapjen e **dy bibliotekave** të rikonstruara, përkatësisht biblioteka "Moikom Zeqo" në rrugën "Tefta Tashko Koço", Njësia Administrative nr.2 si edhe biblioteka "Valter Gjoni" në rrugën "Lord Bajron" pranë Njesisë Administrative nr. 11.
- Vitet e fundit janë zgjeruar programet dhe aktivitetet ndërgjegjësuese rreth dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore. Ndryshe nga një vit më parë ku për shkak të situatës së pandemisë COVID-19 numri i aktiviteteve ndërgjegjësuese ishte relativisht i ulët, këtë periudhë monitorimi Bashkia Tiranë ka zgjeruar gamën e aktiviteteve edhe në terren.
- Gjatë periudhës monitoruese, Bashkia Tiranë ka trajtuar **1272 raste të dhunës** me bazë gjinore dhe në familje gjatë mbledhjeve të ETN-së me anëtarë të MKR-së Tiranë, në bashkëpunim me Njësitë Administrative dhe Qendrat Komunitare.
- Sipas informacioneve zyrtare të përfuara nga Ujësjetës Kanalizime Tiranë, viti 2021 ka një rritje **me 10% të mbulimit me ujë 24 orë**. Në vitin 2020, sipas UKT, Tirana mbulohej në 60% të territorit me ujë pa ndërprerje, ndërsa në vitin e dytë monitorues mbulohet **70% e territorit** të Tiranës me ujë 24 orë.
- Sa i përket sigurisë së ujit të pijshëm, shoqëria "Ujësjetës Kanalizime Tiranë" sh.a. është në monitorim të vazhdueshëm nga institucionet kompetente, për zbatimin rigoroz të plotësimit të kushteve higjieno – sanitare të puseve dhe stacioneve të pompimit, përcaktuar në "Direktivën e Këshillit të Europës 98/83/EC, datë 03.11.1998, mbi cilësinë e ujit për konsum njerëzor" dhe rregulloren "Cilësia e ujit të pijshëm" miratuar me Vendimin nr.379, datë 25.05.2016 të Këshillit të Ministrave. **Shoqëria UKT sh.a. garanton se, uji që del nga depot dhe furnizon rrjetin e shpërndarjes është brenda parametrave të kërkuar dhe është totalisht i sigurtë.**
- Vijnë problematikat me transportin publik përse i përket kohës së pritje në stacionet e linjave rrethqytetese dhe mungojnë afishimet e orareve në stacionet pritëse.

Analiza e gjetjeve për secilin Prioritet sipas Kontratës Sociale

Gjetjet nga monitorimi dhe informacioni i Bashkisë Tiranë

Prioriteti nr. 1:

Shërbime veterinare në zonat rurale: Zgjerim i shërbimit veterinar në Njësitë Baldushk, Dajt dhe Farkë.

Sipas Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, veterinerët zyrtarë janë nën varësinë e Agjencisë Rajonale të Shërbimit Veterinar, në varësi të Ministrisë së Bujqësisë. Nga ana e strukturave të kësaj Agjencie pranë Bashkisë Tiranë, kryhet monitorim i vazhdueshëm në të gjitha Njësitë Administrative rurale, sipas përcaktimit të legjislacionit veterinar në fuqi.

Sipas Bashkisë Tiranë, janë adaptuar ndryshimet në Ligjin nr.10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, publikuar me datë 24.1.2020.

VKM-ja nr. 475, dt. 31.07.2021, ka specifikuar qartazi rolin e pushtetit vendor në fushën e shërbimit veterinar. Gjithashtu, edhe Urdhëri i Ministrit të Bujqësisë, dt 8.09.2021, ka përcaktuar përfundimisht afatin për kalimin e këtyre funksioneve nga Njësitë e Qeverisjes Vendore, tek pushteti qendror. Afat ky që ka përfunduar në datën 15.10.2021. Tanimë Bashkia Tiranë kryen vetëm monitorim të profilaksisë në bashkëpunim me strukturat e Shërbimit Veterinar Rajonal. VKM-ja nr 475, ka përcaktuar që vetëm kontrolli dhe trajtimi i kafshëve endacake është funksion ligjor i Njërive të Qeverisjes Vendore.

Prioriteti nr. 2:

Nxitja e biznesit të rinjtë, gratë dhe grupet vulnerabël: Zgjerimi i programeve ekzistuese me fokus të rinjtë dhe gratë.

Në lidhje me këtë prioritet, në buxhetin e Bashkisë Tiranë ka patur rritje, mbështetje dhe bashkim projekteve. Projekti “Fuqizimi të rinjve dhe të rejave” ka ardhur si rrjedhojë e bashkimit të dy projekteve: “Të rinjtë dhe të rejat drejt një profesioni” me buxhet 5.000.000 Lekë dhe projektit “Biznesi Rinor” me buxhet 10.000.000 Lekë.

Efektet financiarë në bashkimin e dy projekteve është 16.000.000 Lekë dhe numri i përfituesve është 20. Për një përfitues, masa është 800.000 Lekë, gjithashtu ky projekt është me bashkëfinancim në masë 200.000 Lekë.

Thirrja për këtë vit u shpall nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, nëpërmjet Drejtorisë së Nxitjes së Punësimit, bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak, nr 82, datë 02.07.2021, për zbatimin e projektit “Fuqizimi i të rinjve dhe të rejave”. Kjo drejtori ka kryer publikimin e projektit në stendën e njoftimeve për publikun si dhe në faqen e internetit të Bashkisë Tiranë, si thirrje e hapur për dorëzimin e aplikimeve për grantin që do të mbështesë të rinjtë e prekur nga pandemia globale e shkaktuar nga COVID-19. **Në numrin e përfituesve nuk ka rritje krahasuar me një vit më parë.**

Informimi i çeljes së 2 projekteve “Fuqizimi i të rinjve dhe të rejave” dhe “Fuqizimi i grave dhe nxitja e sipërmarrjes” është bërë në faqen zyrtare, duke lënë kontaktet e koordinatorit për informacion të mëtejshëm. Gjithashtu, janë zhvilluar takime informuese (duke respektuar masat anti COVID-19) me të rinjtë, gratë dhe gjithë të interesuarit.

Prioriteti nr. 3:

Mbështetja e fermerëve: Zhvillimi i programeve ekonomike që mbështesin fermerët – Njoftimi i tyre nga drejtoritë përkatëse në Njësitë Administrative dhe asistencë teknike e profesionale.

Në lidhje me Agjensinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZhBR), çdo vit lançohen programe ekonomike në mbështetje të fermerëve, dhe çdo vit ajo ndjek dy programe:

1. **IPARD** (Programi IPARD është mbështetje financiare për bujqësinë dhe zhvillimin rural nga fondet e BE-së (75%) dhe qeverisë shqiptare (25%).) Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Rural (DZHER) pranë Bashkisë Tiranë nuk disponon një numër të saktë të fermerëve të zonave rurale të Tiranës, të cilët kanë përfituar nga program IPARD.

Sipas monitorimit të kryer nga QAGjZh, gjatë vitit 2021 AZhBR ka mbyllur thirrjen për aplikim në datë 25 Janar 2021 për fondet e programit IPARD 2, me një shumë financimi prej 30 mln Euro, me 360 aplikime në total. Institucioni përgjegjës e konsideron këtë thirrje të suksesshme, pasi duke parë situatën vitin e kaluar, pritshmëritë ishin për 150 aplikime, por niveli ka qenë i lartë edhe pse këto fonde ishin të dedikuara për dy masa, kryesisht për ferma dhe sektorin agropërpunues. Në total nga fondi prej 90 mln Euro i programit IPARD, me tre thirrje 1,2,3, pritet të lidhen 500 kontrata investimi.

2. **Skema Kombëtare** (Skema Kombëtare është mbështetje financiare për bujqësinë dhe zhvillimin rural nga buxheti i qeverisë shqiptare). Gjatë vitit 2020 ishin 94 përfitues të kësaj skeme në Bashkinë Tiranë, ndërsa gjatë vitit 2021 numri i përfituesve ra në 54 në total.

Bashkia Tiranë, në kuadrin e politikave të zhvillimit të zonave rurale të Tiranës, me qëllim nxitjen dhe zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë, po ndërmerr një fushatë për këshillimin e fermerëve dhe sensibilizimin e tyre mbi kultivimin e tokave bujqësore, përshtatjes së kulturave me nevojat e tregut dhe përdorimit sa më efikas të aseteve që ata disponojnë. Shërbimi Këshillimor Bujqësor (ekstensioni) është një nga instrumentet e rëndësishëm për realizimin e politikave të zhvillimit rural që ka për detyrë të kontribuojë në rritjen e prodhimit bujqësor dhe të ardhurave të fermerëve, nëpërmjet përzgjedhjes, përgatitjes dhe shpërndarjes së informacionit si dhe menaxhimit më të mirë të fermës, strategjisë së marketingut dhe financave. Në thelb, ky shërbim ka si qëllim t’u ofrojë fermerëve asistencë teknike dhe ekonomike në teknologjinë e prodhimit bimor, blegtoral, sigurimin e inputeve cilësore, tregjeve, çmimet, legjislacionin, menaxhimin e fermës, mundësitë e kreditimit, përpunimit, etj. Gjatë periudhës Shtator 2020 - Shtator 2021, nga ana e specialistëve të DZHER-së janë realizuar rreth 35 takime, ku kanë marrë pjesë mbi 250 fermerë.

Prioriteti nr. 4:

Taksat bashkiake: *Krijimi i lehtësive për tarifaf e taksave bashkiake për kategoritë në nevojë si gra kryefamiljare, invalidë të punës, persona me aftësi ndryshe, vajza-nëna.*

Njësoj si një vit më parë edhe gjatë vitit të dytë të monitorimit nuk ka ndryshime sa i përket tarifave dhe taksave bashkiake për këtë kategori. Në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.158, datë 26.12.2019 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës" i ndryshuar, nuk janë parashikuar lehtësira sipas prioritetit të mësipërm. Sipas informacioneve të përfutuara, pasi Bashkia Tiranë të bëjë një studim më të hollësishëm (si në grumbullim informacioni ashtu edhe në implementim), mund të parashikohen lehtësira për këto kategori në VKB-në e ardhshme.

Prioriteti nr. 5:

Kopshtet dhe çerdhet: *Ndërtimi i kopshteve dhe çerdheve të reja në të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë, por sidomos në zonat rurale, në veçanti i çerdheve në Farkë dhe Dajt ku mungon plotësisht ky shërbim.*

Gjatë periudhës monitoruese një vjeçare Shtator 2020 – Shtator 2021, janë bërë disa ndërhyrje sa i përket çerdheve dhe kopshteve për fëmijë, specifikisht:

- 5.1 Kopshti Sauk - hapet shërbimi i ri me ushqim dhe orar të plotë. (Shtator 2020)
- 5.2 Çerdhja 33, Njësia Administrative nr. 5 - dyfishim kapaciteti, marrje objekti tjetër me qira. (Shtator 2020)
- 5.3 Çerdhja 8, Njësia Administrative nr. 10 - dyfishim kapaciteti, shtesë godine e re. (Tetor 2020)
- 5.4 Çerdhja 11, Njësia Administrative nr. 11 - dyfishim kapaciteti, shtesë godinë e re. (Mars 2021)
- 5.5 Çerdhe dhe Kopsht i integruar Qesarakë, Njësia Administrative Dajt - shërbim i ri. (Prill 2021)
- 5.6 Çerdhja në vendin e punës - BKT. (Shtator 2021)
- 5.7 Kopshti Fikas - objekt i ri me dyfish kapacitet. (Shtator 2021)
- 5.8 Çerdhe dhe kopsht i integruar - Njësia Administrative nr. 5. (Shtator 2021)

Sipas Kontratës Sociale:

- Është rikonstruktuar çerdhja nr. 11, në Njësinë Administrative nr. 11.
- Në Njësinë Dajt, është hapur shërbimi i ri i çerdhes dhe i kopshtit, me kapacitet 200 fëmijë.
- Kopshtet në zonat rurale vijojnë të jenë pa drekë në pjesën më të madhe të tyre. Në Prill 2021 është hapur shërbimi i ri me ushqim në Qesarakë, Njësia Administrative Dajt, si dhe prej Shtatorit 2021, objekti i ri në Fikas (Kopshti Petrelë) ofron shërbim me kohë të plotë dhe ushqim, për fëmijët e Njesisë Administrative Petrelë si dhe për fëmijët e Njësive Administrative kufitare. Kopshti Gurrë, objekti i të cilit ka mbaruar, hapet së shpejti dhe është planifikuar me ushqim, si dhe objektet e tjera të planifikuara në zonat rurale janë planifikuar me ushqim.

Prioriteti nr. 6:

Zgjerimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror për individët në nevojë

Shërbime rezidenciale për të moshuarit

Bashkia Tiranë njësoj si një vit më parë, vijon në ofrimin e shërbimit rezidencial për të moshuar dhe persona që jetojnë në situatë rruge, target-grup i vlerësuar si më vulnerabël, përmes Qendrës Sociale “Strehëza Tiranë”, si një shërbim i kompletuar, që fillon me identifikimin në terren nga stafe të specializuara por dhe në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, ofron asistencën e parë në vend, duke vijuar me paketën e plotë të shërbimeve të kujdesit në strehëzën “Tirana” me higjenizim, veshmbathje, vakte ushqimore, kujdes shëndetësor, mbështetje psiko-sociale dhe orientim për shërbime të tjera sipas të drejtave. **Shërbime të reja rezidenciale nuk janë ngritur** dhe vijnë të funksionojnë shërbimet ekzistuese duke mbuluar nevojat e të moshuarve dhe sipas numrit të ulët të kërkesave për shërbime rezidenciale pranë Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale.

Shërbime të reja për moshën e tretë për zonat rurale

Në Bashkinë e Tiranës aktualisht po zbatohen 2 projekte për të moshuarit në bashkëpunim me OSHC-të, projekti me titull: “Nuk je vetëm!” (Asistencë shtëpiake për të moshuarit në nevojë) nga Qendra për “Administrim Social Ekonomik”, ku do të jenë përfitues **35 të moshuar** dhe projekti me titull: “Shërbimi multidisiplinar në banesë për të moshuarit në nevojë dhe të vetmuar, në Bashkinë Tiranë”, ku ka përfitues edhe nga Njësitë Administrative Dajt, Zall-Herr, Sauk, Baldushk, Ndroq, Kashar, Farkë, Selitë, Vaqarr.

Familje që jetojnë në bodrume apo në shtëpi pa kushte minimale jetese.

Që prej vitit 2016 kanë përfituar 4759 aplikues të kësaj kategorie bonus qeraje apo strehim social, nga 12886 aplikues në total.

Gra të mbijetuara të dhunës në familje dhe strehimi social apo/dhe bonusi i qerasë.

Gjatë periudhës Janar - Shtator 2021, numri total i aplikimeve të programit social "Subvencionimi i qirasë" për kategoritë e kryefamiljareve me fëmijë, vajza-nëna/gra të dhunuara, me Urdhër Mbrojtje apo të divorcuara, ishte 144 aplikime. **Numri i përfituesve nga ky program social është 69.**

Qendrat komunitare për kategoritë në nevojë në Njësitë 2, 5, 7 dhe Farkë

Shërbimi Komunitar Lëvizës ka filluar të funksionojë që prej Dhjetorit 2019 (gjatë vitit të parë monitorues të Kontratës Sociale) në **Njësinë Administrative Farkë**. Bashkia Tiranë në bashkëpunim me **SOS Fshatrat në Shqipëri**, ofrojnë shërbime lëvizëse sa më pranë familjes dhe anëtarëve të komunitetit dhe në kuadër të këtij bashkëpunimi Bashkia Tiranë, Njësia Administrative Farkë, ka vendosur në dispozicion për ofrimin e shërbimeve ambiente pranë Njësisë Administrative Farkë, burimet njerëzore për zbatimin e suksesshëm të shërbimeve në kuadër të shërbimeve me bazë komunitare përmes qasjes së menaxhimit të rastit, informimit,

këshillimit psikosocial dhe psikologjik, ndihmë direkte, programe passhkolle për fëmijet dhe të rinjtë, programin e prindërimit pozitiv, mobilimin e komunitetit etj.

Bashkia Tiranë së bashku me organizatën jofitimprurëse “**Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS**”, ka finalizuar bashkëpunimin për ngritjen e shërbimeve për të mbrojtur fëmijët nga abuzimi, neglizhimi, dhuna dhe shfrytëzimi në Tiranë, por dhe të rinjtë dhe gratë, nëpërmjet një qendre komunitare multidisiplinare, me shërbime specifike si: shërbimi i emergjencës 72 orë dhe shkolla e lëvizshme në **Njësinë Administrative 7**.

Në përmbushje të funksioneve të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore në qendrat komunitare të Bashkisë Tiranë si, “Të Qëndrojmë së Bashku”, “Gonxhe Bojaxhi”, “Qendra Komunitare Multidisiplinare” dhe “Qendra Komunitare Shkozë”, është rritur numri i përfituesve për shkak të rritjes së kohëzgjatjes të shërbimit ditor përgjatë gjithë ditëve të javës, pra, shërbime 8:00 – 20:00 nga e hëna në të premte dhe të shtunën 09:00-14:00.

Në arritje të mbulimit me shërbime sociale të çdo komuniteti të Bashkisë Tiranë, qendrat e mësipërme komunitare do të ofrojnë shërbime për një shpërndarje më të madhe territoriale, si më poshtë vijon:

Qendra Komunitare Shkozë	Qendra Komunitare Multidisiplinare	Q endra “Të Qëndrojmë së Bashku”	Qendra Komunitare Shkozë
Nj.A.nr.1	Nj.A.nr.5	Nj.A.nr.6	Nj.A.nr.4
Nj.A.nr.2	Nj.A.nr.9	Nj.A.nr.7	Nj.A.nr.8
Nj.A.nr.3	Nj.A.nr.10	Nj.A.nr.14	Nj.A.nr.11
Nj.A.Bërzhitë	Nj.A.nr.12	Nj.A.Kashar	Nj.A.Zall-Herr
Nj.A.Farkë	Nj.A.Baldushk	Nj.A.Ndroq	Nj.A.Zall-Bastar
	Nj.A.Petrelë	Nj.A.Pezë	Nj.A.Shëngjergj
	Nj.A.Krrabë	Nj.A.Vaqarr	Nj.A.Dajt

Aksesi tek shërbimet sociale të ngritura nga Bashkia për banorët e zonave rurale

Njëjtë si një vit më parë, Bashkia Tiranë, me mbështetjen e Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara (PNUD) për projekte me objekt “**Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve lokale të mbrojtjes sociale**”, ka mundësuar një projekt në fushën “Grante për shërbime të integruara shëndetësore dhe sociale”, kjo, jo vetëm si shërbim jo i kudogjendur në aspektin social, sidomos për zonat rurale, por edhe për pilotimin e tyre në prag të kompetencave që priten t’i kalojnë pushtetit vendor në konceptin e shërbimeve të integruara social-shëndetësore. Aktualisht, përmes Shoqatës Kombëtare “Edukim për Jetën”, po zbaton projektin “Shërbim lëvizës shëndetësor dhe komunitar në zonat rurale”, që në thelb është një njësi lëvizëse që ka për qëllim identifikimin e nevojave të rasteve për kujdes shëndetësor, komunitar, informim, këshillim, ndërgjegjësim, referim e shoqërim drejt shërbimeve si dhe ndjekje të rasteve sipas procedurave të menaxhimit të rastit.

Një tjetër aspekt i ndërhyrjes lidhet me fuqizimin e familjes dhe komunitetit në zonat rurale, duke ofruar programe të cilat lidhen me edukimin shëndetësor, sesione informuese dhe trajnuese për prindërimin pozitiv, kujdesin gjatë fëmijërisë së hershme, mirëushqyerjen, higjienën, vaksinimin, kujdesin gjatë pandemisë Covid 19 etj.

Strehimi Social

Trajtimi i të pastrehëve në qytetin e Tiranës po realizohet në bazë të Ligjit Nr. 22, datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, mbi bazën e të cilit programet sociale të strehimit që kanë gjetur zbatim në Bashkinë e Tiranës gjatë periudhës Shtator 2020 - Shtator 2021, renditen si më poshtë:

1. Subvencionim i interesave të kredisë
2. Subvencionim i qirasë

Subvencionimi i interesave të kredisë: Program i financuar me fondet e buxhetit të shtetit, i cili synon të mbështesë në blerjen e shtëpive të para, me qëllim përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës, ku një pjesë e interesave subvencionohen nga buxheti i shtetit.

Subvencionimi i qirasë (Bonusi i qirasë): Instrumenti sipas të cilit Bashkia subvencionon një pjesë të konsiderueshme të qirasë, për familjet të cilat jetojnë me qira dhe kanë të ardhura të pamjaftueshme për ta përballuar atë.

Përgjatë periudhës Shtator 2020-Shtator 2021 janë miratuar **11 Vendime të Këshillit Bashkiak me 319 përfitues të "Subvencionim i qirasë" dhe 1 Vendim i Këshillit Bashkiak me 806 përfitues të "Subvencionim i interesave të kredisë"**. Ndër to janë shpallur përfituese (të dy programeve së bashku) 566 gra, nga të cilat 5 janë të mbijetuara të dhunës në familje.

Prioriteti nr. 7:

Ngritja e shkollave të reja në Njësitë Administrative të bashkisë Tiranë

Gjatë vitit të parë monitorues, Bashkia e Tiranës realizoi ndërhyrje dhe rikonstrukcion në 12 shkolla në territorin e saj, ku u përfshinë Njësitë Administrative Baldushk, Dajt, 1, 2, 3, 5 dhe 8.

Gjatë periudhës së monitorimit Shtator 2020-Shtator 2021 dhe bazuar në monitorimin e GADC-së dhe në informacionin e përftuar nga Bashkia Tiranë, janë rindërtuar 6 shkolla. Gjithashtu, janë ndërtuar nga e para dhe kanë hapur dyert për nxënësit në Shtator të 2021 edhe 2 shkolla të tjera. Ndërkohë që, aktualisht Bashkia Tiranë ka planifikuar ndërtimin e 4 shkollave të tjera, të cilat do të jenë gati dhe funksionale brenda vitit 2022.

Paralelisht janë bërë ndërhyrje me punime hidraulike; elektrike etj. në 27 shkolla 9-vjeçare dhe të mesme në territorin e bashkisë Tiranë. 6 prej këtyre shkollave kanë përfituar edhe mirëmbajtje të thellë të tualeteve dhe 5 prej tyre mirëmbajtje të thellë të sistemeve të ngrohjes qëndrore me kaldajë. Listën e detajuar të shkollave përfituese e gjeni në aneksin numër 1.

Prioriteti nr. 8:

Ngritja e bibliotekave të lagjeve

Gjatë vitit të parë, pas firmosjes së Kontratës Sociale POP, nuk ishte ngritur asnjë bibliotekë e re, kjo edhe për shkak të situatës së krijuar nga tërmeti dhe pandemia COVID-19. Megjithatë Bashkia e Tiranës kishte në fokus shtimin e numrit të bibliotekave, u bë rikonstruktimi i 4 bibliotekave në Njësitë Administrative 7, 8, 9 dhe 10. Ndërkohë që, përgjatë atij viti ishin në proces rikonstruksioni 3 biblioteka të tjera në Njësitë Administrative 2, 6 dhe 11.

Ndërkohë që gjatë vitit 2021, në kuadër të projektit "Bibliotekat e lagjeve si Qendra Multifunktionale", Bashkia Tiranë ka inauguruar hapjen e dy bibliotekave të rikonstruktuar, përkatësisht biblioteka "Moikom Zeqo" në rrugën "Tefta Tashko Koço", Njësia Administrative nr.2 si edhe bibliotekën "Valter Gjoni" në rrugën "Lord Bajron" pranë Njesisë Administrative nr. 11.

Prioriteti nr. 9:

Zgjerim i programeve ndërgjegjësuere në lidhje me dhunën në familje dhe pasojat e saj

Vitet e fundit janë zgjeruar programet dhe aktivitetet ndërgjegjësuere rreth dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore. Ndryshe nga një vit më parë, ku për shkak të situatës së pandemisë COVID-19, numri i aktiviteteve ndërgjegjësuere ishte relativisht i ulët, këtë periudhë monitorimi Bashkia Tiranë ka zgjeruar gamën e aktiviteteve edhe në terren.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar:

- **8 aktivitete informuese** me aktorë kyç për adresimin e dhunës në familje në Njësitë Administrative Krrabë, Bërzhitë, Petrelë, Vaqarr, Pezë, Farkë, Ndroq, Shëngjergj, me 79 pjesëmarrës.
- **8 forume të hapura diskutimi** me të rinjtë e Njësive Administrative Krrabë, Bërzhitë, Petrelë, Vaqarr, Pezë, Farkë, Ndroq, Shëngjergj, me 117 pjesëmarrës.
- **2 trajnime me anëtarët e ETN** mbi protokollet e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit, me 59 pjesëmarrës.
- **Fushata online "Të gjithë bashkë mund t'ia dalim për të adresuar dhunën në familje"**. Bashkia e Tiranës në bashkëpunim me "Strehëzën për Gra dhe Vajza" dhe Qendrën për Zhvillim Komunitar "Sot për të Ardhmen", pjesë e MKR Tiranë, dhe me mbështetjen e UNDP, ka zhvilluar fushatën online "Të gjithë bashkë mund t'ia dalim për të adresuar dhunën në familje", në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore (25 Nëntor-10 Dhjetor 2020). Qëllimi i kësaj fushate ishte promovimi i punës dhe rolit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje, të Bashkisë

Tiranë dhe të jepeshin mesazhe ndërgjegjësuere nga secili anëtar i ETN-së. Çdo ditë të fushatës u postua në mediat sociale fotoja dhe mesazhi i një anëtari të ETN-së.

- Ceremonia e ndezjes së instalacionit “REJA” në ngjyrën portokalli në datën 25 Nëntor 2020 nga Bashkia Tiranë.

Gjithashtu, duhet theksuar fakti që Bashkia Tiranë është përfshirë intensivisht në organizimin dhe lehtësimin e aktiviteteve ndërgjegjësuere të OSHC-ve në territorin e saj, veçanërisht atyre pjesë të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit, Tiranë.

Identifikimi i rasteve të dhunës në familje dhe adresimi i tyre

Gjatë periudhës Janar 2020 - 30 Shtator 2021, MKR Tiranë ka arritur:

- të trajtojë **1272⁴ raste të dhunës** me bazë gjinore dhe në familje, gjatë mbledhjeve të ETN-së me anëtare të MKR-së Tiranë, në bashkëpunim me Njësitë Administrative dhe Qendrat Komunitare;
- të përditësojë sistemin REVALB me 529 *raste të dhunës* në familje;
- të mbështesë 107 përfituese nga kategoritë e grupeve në nevojë si, kryefamiljare me fëmijë, vajza-nëna/gra të dhunuara, me Urdhër Mbrojtje apo të divorcuara, përmes programit social “Subvencionimi i qirasë”, për periudhën Janar 2020-Shtator 2021.

Në zbatim të Ligjit nr. 47/2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar, neni 23, pika 3/1: "Gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për UMM/UM-në, Zyra e Shërbimeve Sociale të Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore monitoron respektimin e Urdhrit të Mbrojtjes nga palët dhe çdo 60 ditë përgatit një raport, për të cilin, në çdo rast, vë në dijeni Policinë e Shtetit. Palët përkatëse në vendimin gjyqësor bashkëpunojnë për të siguruar vizitat në banesë të përfaqësuesve të Zyrës së Shërbimeve Sociale dhe institucioneve përgjegjëse, sipas vendimit të Gjykatës për Urdhrin e Menjëhershëm të Mbrojtjes dhe/ose Urdhrin e Mbrojtjes, duke dhënë edhe informacionin e nevojshëm." i janë dërguar **104 raporte periodike monitorimi të zbatimit të urdhrave të mbrojtjes** komisariateve përkatëse të policisë Tiranë gjatë periudhës Maj-Tetor 2021. Në rastet kur janë evidentuar thyerje të masave të Urdhrit të Mbrojtjes, përveç dërgimit të menjëhershëm të raportit të monitorimit, është vënë në dijeni komisariati përkatës i policisë për vëmendje të shtuar.

Koordinatori Vendor në bashkëpunim me pikat fokale në Njësitë Administrative, ka arritur menaxhimin dhe monitorimin e rasteve të dhunës në familje në përputhje me detyrimet e ngarkuara nga ndryshimet e reja ligjore.

⁴Kjo shifër vjen nga mbledhja e numrit të rasteve të trajtuara nga institucione të ndryshme të Mekanizmit, që do të thotë se numri real i rasteve të trajtuara të dhunës në familje mund të jët më i ulët, pasi një rast dhune mund të ketë marrë shërbime në më shumë se një institucion anëtar të Mekanizmit dhe për rrjedhojë është rinumëruar.

Zgjerimi shërbimeve ekzistuese mbrojtëse

Në kuadër të prioritetit për zgjerimin e shërbimeve ekzistuese mbrojtëse për viktimat e dhunës në familje, gjatë muajit Janar 2021 është nënshkruar një marrëveshje e veçantë midis Bashkisë Tiranë dhe Organizatës "**Të Ndryshëm & Të Barabartë**" me efekt 1 vjeçar, me qëllim riintegrimin e viktimave të dhunës me bazë gjinore si dhe rritjen e njohurive dhe kapaciteteve të autoriteteve lokale për të zhvilluar plane të integritit socio-ekonomik për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore. Përfituese të drejtpërdrejtë të kësaj marrëveshjeje do të jenë të paktën 20 të mbijetuara të dhunës me bazë gjinore, të cilat do të mbështeten me shërbime riintegruese gjithëpërfshirëse.

Përfitues të tjerë janë stafi i Bashkisë së Tiranës dhe organizatat lokale të shoqërisë civile përmes ofrimit të trajnimeve, mentorimit dhe formave të tjera të mbështetjes për të pilotuar zbatimin e planeve socio-ekonomike për të mbijetuarat e dhunës me bazë ligjore.

Planet e ndjekura nga Mekanizmi i Koordinuar i Referimit për integrimin e të mbijetuarave të dhunës në familje dhe për pavarësinë e tyre ekonomike.

Bashkia Tiranë në rolin e drejtuesit të MKR-së mbështet gratë dhe vajzat, veçanërisht nga grupet e veçanta përmes programeve të shërbimeve sociale dhe programeve të nxitjes së punësimit. Nismat e ndërrmarra për fuqizimin ekonomik e social të grave dhe vajzave të reja përfshijnë dy programe të mëdha të mbështetura nga fondet e Bashkisë, që janë:

- **"Fuqizimi i Grave dhe Nxitja e Sipërmarrjes"**- Program i cili ka filluar që në vitin 2016 dhe ka si objektiv nxitjen e grave dhe të rejave për t'u përfshirë në sipërmarrje duke çelur biznese të reja apo duke zhvilluar më tej bizneset ekzistuese, me ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e mirëqenies familjare dhe qytetare.

Në vitin 2020 ka pasur 52 përfituese në total, ku nga këta 30 start-up dhe 22 ekzistuese.

Në vitin 2021 është çelur thirrja për aplikim nga data 04.10.2021 deri me date 22.10.2021, për të gjitha gratë dhe vajzat banore të Bashkisë Tiranë, kryesisht të kategorive në nevojë si, gra kryefamiljare, gra nga zonat rurale, gra me aftësi të kufizuara, gra nga grupet e minoriteteve etnike, gra viktime të dhunës në familje e të trafikimit etj.

- **"Programi i Nxitjes së Punësimit në ndihmë të krijimit të Biznesit Social Rinor"**
Programi ka filluar që në 2017 dhe ka si qëllim të mbështesë me plane të qëndrueshme biznesi të krijuara nga të rinjtë dhe të rejtat të prekur për shkak të pandemisë globale COVID -19 si dhe të japë kontribut në kuadër të zvogëlimit të pasojave të shkaktuara nga COVID-19. Përveç mbështetjes në formë granti, programi do të ofrojë gjithashtu trajnim

për aftësitë në biznes si dhe mbështetje duke ndihmuar të rinjtë me orientim dhe kualifikim profesional.

Në vitin 2020 kanë përfituar 39 të rinj dhe të reja në total, ku nga këta 27 start-up dhe 12 ekzistues.

Në vitin 2021 kanë aplikuar 55 të rinj dhe të reja në total, prej të cilëve 31 aplikantë kanë marrë pjesë në trajnim për aftësi të përgjithshme biznesi. Ndërkohe muaji Tetor është muaji për përgatitjen dhe dorëzimin e planeve të biznesit. Nga këto aplikime, 20 plane biznesi do të shpallen fitues dhe do të firmosin një kontratë 12 mujore për të marrë financimin e grantit

Nëpërmjet programit të ndërmarrjeve sociale, Bashkia Tiranë synon promovimin e barazisë gjinore përsa i përket rritjes së mundësive në aksesimin e tregut të punës, uljen e shkallës së papunësisë së grave dhe vajzave dhe rritjen e përfshirjes në programet e nxitjes së punësimit.

Bashkia Tiranë ka nxitur rrjetëzimin me sektorin privat dhe shoqërinë civile për arritjen e parimeve të barazisë gjinore në vendet e punës, duke ofruar për të gjitha gratë e vajzat shanse të barabarta dhe trajnime, shëndet dhe siguri në punë. Gjatë vitit 2021, 42 individë janë ndërmjetësuar për punësim me bizneset private.

Prioriteti nr.10:

Adresimi me prioritet i furnizimit me ujë dhe problemeve me kanalizimet e ujërave të zeza

Sipas informacioneve zyrtare të përfituara nga “Ujësjellës Kanalizime Tiranë”, vitit 2021 ka një rritje me 10% të mbulimit me ujë 24 orë. Në vitin 2020 sipas UKT, Tirana mbulonte 60% të territorit me ujë pa ndërprerje, ndërsa në vitin e dytë monitorues mbulohej 70% e territorit të Tiranës me ujë 24 orë.

Furnizimi i pandërprerë me ujë i rrjetit në administrim të shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime Tiranë” sh.a. ishte një nga objektivat strategjike të kësaj shoqërie, në përmbushje të të cilit është edhe zbatimi i projektit “Shtesë e impiantit të përpunimit të ujit të pijshëm Bovillë me 1800 l/sek. në fazën e dytë të zbatimit me 1200 l/sek.”, miratuar me Vendimin nr.5, datë 26.01.2021 të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT). Qëllimi dhe synimi kryesor i shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime Tiranë” sh.a. është që, në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë, të mundësohet mbulimi i furnizimit të rrjetit me ujë të pijshëm 24/7, hartë e cila vazhdon të zgjerohet që pas ndërhyrjeve të kryera në impiantin e përpunimit të ujit në Bovillë. Sipas vlerësimeve në terren, 70% e territorit të qytetit të Tiranës mbulohej me furnizim 24 orë ujë, ndërsa 30% e territorit të qytetit të Tiranës mbulohej me furnizim me ujë sipas gjendjes së sasisë në burimet nga ku e marrin furnizimin me ujë.

Sa i përket sigurisë së ujit të pijshëm, shoqëria “Ujësjetës Kanalizime Tiranë” sh.a. është në monitorim të vazhdueshëm nga institucionet kompetente, për zbatimin rigoroz të plotësimit të kushteve higjieno – sanitare të puseve dhe stacioneve të pompimit, përcaktuar në “Direktivën e Këshillit të Europës 98/83/EC, datë 03.11.1998, mbi cilësinë e ujit për konsum njerëzor” dhe rregulloren “Cilësia e ujit të pijshëm” miratuar me Vendimin nr.379, datë 25.05.2016 të Këshillit të Ministrave. Shoqëria UKT sh.a. garanton se, uji që del nga depot dhe furnizon rrjetin e shpërndarjes është brenda parametrave të kërkuar dhe është totalisht i sigurtë.

Prioriteti nr. 11:

Shtimi i autobusëve në linjat e Njësive Administrative

Një prej prioriteteve të Kontratës Sociale ishte edhe shtimi i numrit të autobusëve sidomos për linjat e Njësive Administrative rurale Dajt, Baldushk dhe Farkë. Ky prioritet vijon me problematika dhe i papërbushur.

Sipas bashkisë Tiranë, orari i transporti publik është 06:00 - 23:00 çdo ditë (pavarësisht festave ose ditës së javës) dhe ky orar respektohet edhe bazuar në monitorimin e GADC-së. Numri total i stacioneve është 451 dhe pritja mund të variojë nga 3 deri në 13 minuta sipas linjave të autobusëve dhe orarit (orar piku ose orar normal). Sipas monitorimit pritja varion edhe 30-45 minuta në stacione të ndryshme, sicc është ai i kopështit zoologjik; Farka, Baldushku, Dajti etj.

Sipas informacionit zyrtar nga Drejtoria e Transportit dhe Trafikut Rrugor, bashkia Tiranë, kompletimi me publikimin e orareve në stacionet e linjave qytetese do të realizohet me projekte së afërmi. Ndërsa stacionet e linjave rrethqytetese do të trajtohen në projekte të ardhshme.

Gjetjet nga fokus-grupet me komunitetin Tiranë

Në të njëjtën kohë me monitorimin dhe mbledhjen e informacionit nga Bashkia Tiranë, GADC organizoi fokus-grupe me komunitetin në njësi të ndryshme administrative të kësaj bashkie, njësi në të cilat dolën edhe prioritetet kryesore. Në bazë të komunikimeve dhe gjetjeve prej tyre, qytetarët kanë identifikuar disa ndryshime pozitive të cilat janë pjesë e Kontratës Sociale, por kishte edhe prioritete të cilat sipas tyre nuk janë përbushur. Një pasqyrë e gjetjeve të këtyre takimeve paraqitet si më poshtë vijon, e ndarë sipas Njësive Administrative:

Njësia Administrative nr. 1

- Nevojë për rishikimin e taksave për kategorinë e nënave kryefamiljare – të cilat edhe nga gjetjet e bashkisë, rezulton se nuk është mundësuar akoma.
- Janë bërë disa ndryshime pozitive për çerdhet dhe kopshtet e fëmijëve.
- Sipas banorëve të kësaj njësie, është e nevojshme ngritja e bibliotekës, që megjithëse ka patur ndryshime pozitive në rang bashkie, për këtë njësi nuk është plotësuar akoma.

- Banorët janë të mirëinformuar sa i përket ndërgjegjësimit për të mos pranuar dhunën në familje por, kërkohen banesa sociale apo zgjidhje të tjera që e mbijetuara e dhunës të mos jetojnë në të njëjtën shtëpi me dhunuesin.
- Furnizimi me ujë të pijshëm funksionon në rregull.
- Ka patur përmirësime në blloqet që kufizohen nga rrugët “Dhimitër Kamarda” dhe “Kostaq Cipo”.
- Është kryer rikualifikimi i bllokut që kufizohet nga rrugët “Bashkim Kodra”, “Spahiu”, “Shpëtim Zajmi”, Shkozë.
- Sipas banorëve ka përfunduar ndërtimi i banesave për komunitetin Egjiptian dhe atë Rom pranë banesave sociale Shkozë si dhe ndërtimi i banesave në Lanabregas.
- Është rehabilituar dhe bërë rikonstrukcioni i plotë i rrugëve “Ali Demi” dhe “Ali Shefqeti”.
- Aktualisht po finalizohet projekti i unazës së jashtme të Tiranës dhe ndërtimi i rrugëve paralele, segmenti “Materniteti i ri Koço Glliozheni-Unaza e Jashtme e Tiranës”, investim nga ARRSH.

Njësia Administrative nr. 2

- Pjesëmarrësit në takim janë të kënaqur me disa lehtësira nga tarifat e taksave vendore.
- Ka nevojë për kopshte dhe çerdhe.
- Ka nevojë për qendër shërbimesh për të moshuarit, mundësisht në të gjithë zonën.
- Janë të kënaqur me numrin e shkollave.
- Biblioteka “Moikom Zeqo” është rikonstruktuar.
- Rruga lidhëse e shkollës “Qemal Stafa” me rrugën “Hoxha Tasim” është rregulluar.
- Pranë shkollës “Mihal Grameno”, rruga “Hekuran Mara” ka nevojë për asfaltim.

Njësia Administrative nr. 3

- Përveç pensionistëve, asnjë nga banorët nuk kanë përfituar reduktim dhe rimbursim taksash dhe tarifash, sidoqoftë ata shprehin vlerësimin e tyre për shërbimin dhe sjelljen që i ofrohet nga stafet e Njesisë nr.3.
- Përsa i përket Njesisë nr. 3, banorët i shikojnë si të mjaftueshme shkollat, kopshtet dhe çerdhet, duke numëruar 4 kopshte, 3 çerdhe, 1 shkollë të mesme, 4 shkolla 9-vjeçare dhe 1 shkollë speciale. Por, problem aktual është shkolla “Xhezmi Delli”, e cila sipas premtimeve për rikonstrukcion të saj pas tërmetit, duhej të kishte hapur dyert për nxënësit në Shtator të 2021, por nuk është hapur akoma.
- Njësia 3 pretendohet të jetë njësia pilot për furnizimin me ujë 24 orë, por në fakt kjo gjë nuk ndodh, përveç se tek lagjia “Kodra e Priftit”, uji në zonat e njesisë vjen me orar ose edhe mugon shpesh, ndërkohë që banorët shprehen se uji është i papijshëm.
- Janë amortizuar disa rrugë dhe ka probleme me kanalizimet, p.sh lagjia “Ali Baushi” e cila paraqet probleme me kanalizimet, “Besim Zyma” për kanalizimet dhe për amortizimin e rëndë të rrugëve si dhe Rr. “Naun Veqilharxhi”, e cila po ashtu ka problematikë amortizimin e rëndë.
- Mungon mbështetja për personat që kujdesen për fëmijët jetimë të braktisur, në rastin konkret një gjyshe, e cila edhe pse është e aftë për punë, e ka të pamundur të punojë

sepse duhet të kujdeset për dy fëmijët, ndërkohë që nga shteti nuk trajtohet me asnjë ndihmë apo pagesë.

Njësia Administrative nr. 4

- Pastrimi i lagjeve pranë kësaj njësie mbetet një shqetësim për banorët, nuk pastrohet rregullisht, por edhe kur punonjësit e pastrimit fillojnë punën, më së shumti gjatë kohës së paradites, bëjnë një pastrim të përciptë dhe pa efekt.
- Koshat e mbledhjes së mbetjeve prej kohësh nuk po dezinfektohen.
- Rrugët e brendshme nuk po mirëmbahen.
- Lulishtja tek zona afër TV Klan, që prej dy vitesh do të mirëmbahej dhe do të vendoseshin stola, ka mbetur po njësoj.
- Administratorët e pallateve të vendosur nga bashkia, nuk bëjnë punën siç duhet për mirëmbajtjen e ambjenteve të përbashkëta, paçka se paguhen nga banorët në mënyrë të rregullt çdo muaj.
- Ndërkohë që, ujë ka në mënyrë të rregullt 3 herë në ditë, por përsëri edhe këtë vit banorët shprehen se uji nuk është i pijshëm dhe ata e blejnë ujin ose në markete ose me bote nëpër lagje, të cilat së fundmi janë rralluar. Pra, ky prioritet, të paturit ujë të pijshëm 24 orë vijon të jetë i paplotësuar.

Njësia Administrative nr. 5

- Përsa i përket taksave bashkiake, në këtë njësi përfitues janë familjet që jetojnë me ndihmë ekonomike dhe nëse burri dhe gruaja janë pensionistë.
- Në Njësinë nr.5, është rindërtuar kopshti dhe çerdhja me fondin e rindërtimit të pas tërmetit, ndërkohë që banorët vijnë të kërkojnë shtimin e numrit të shkollave, çerdheve dhe kopshteve në njësinë e tyre.
- Sipas banorëve, mungojnë shërbime rezidenciale për të moshuarit dhe qendra komunitare.
- Kërkohet detyrimi për zbatimin e ligjit për depozitat e ujit mbi pallate.
- Sa i përket ujit të pijshëm, banorët shprehen se në njësinë e tyre furnizimi është më orar dhe ka problematika në zonën pas pallatit me shigjeta.
- Edhe pse janë bërë punime për ristrukturimin e rrugës, duke bërë kështu dhe kanalizimet, banorët thonë se tubacionet e ujit nuk janë lidhur dhe nuk janë vënë në funksion. Në Rr. "Vasil Shanto" dhe Rr. "Vaso Pasha" janë bërë instalimet por nuk është lidhur uji i pijshëm.

Njësia administrative nr. 7

- Janë hequr taksat vendore për kategoritë në nevojë (taksat e përfshira në faturën e ujit), ndërsa personat me aftësi të kufizuar dhe invalidët e punës, përfitojnë nga heqja e taksës vetëm nëse familjarët e tyre janë të papunë (e vërtetuar).
- Në lidhje me zgjerimin e programeve ndërgjegjësuese për dhunën në familje, janë rritur rastet e identifikimit të dhunës në familje, nëpërmjet informacioneve nga komuniteti, ndërveprimi ndërlidhës me komunitetin-SPZ, si dhe nga Urdhërat e Mbrojtjes.

- Të mbijetuarat e dhunës në familje trajtohen me ndihmë ekonomike sipas legjislacionit të ndihmës ekonomike për këtë kategori, ndihma ushqimore, apo ndërmjetësime të ndryshme me institucionet apo OJF sipas prioritetit të problematikës.
- Në lidhje me strehimin, qoftë për gratë e dhunuara, qoftë për kategoritë e tjera në nevojë që duhet të aplikojnë për strehim (bonus qeraje, etj.) problem janë pronarët e banesave, të cilët nuk lidhin ligjërisht kontratën e qerasë ndërmjet tyre dhe qeramarrësit. Mungesa e kontratës së qerasë sjell pengesa ligjore jo vetëm në plotësimin e dosjes për të përfituar bonusin e qerasë, por edhe për aplikim për ndihmë ekonomike dhe shërbime të tjera të përkujdesit shoqëror.
- Janë rikualifikuar hapësirat publike ndërmjet pallateve. Është bërë rivitalizimi i fasadave të pallateve në rrugët kryesore dhe rrugët e brendshme të blloqeve të banimit (kjo në bashkëpunim me banorët dhe Bashkisë Tiranë, nëpërmjet fondit komunitar).
- Është realizuar rikonstruksioni në infrastrukturën rrugore dhe ujësjellës-kanalizime.
- Banorët kërkojnë mirëmbajtjen e ambjenteve sportive dhe menaxhimin e mirë të tyre.

Njësia Administrative nr. 8

- Kapacitetet dhe infrastruktura për shkolla dhe çerdhe janë në rregull.
- Furnizimi me ujë të pijshëm është në rregull.
- Janë shtruar rrjetet e reja të ujësjellësit si dhe sahatët mates.
- Janë informuar mbi programet e nxitjes së biznesit dhe procesin e aplikimit për t'u përfshirë në këto programe.
- Ka shumë lehtësira përsa i përket tarifave të taksave bashkiake, kryesisht për pensionistët, familjet që janë përfituese të ndihmës ekonomike si dhe personat me aftësi të kufizuara.
- Është e rëndësishme për këtë njësi ngritja e një qendre të re sociale, që ka në tërësi të gjitha shërbimet e komunitetit, nga ushqimi e deri tek shërbimet shëndetësore për të gjitha grupmoshat. Gjithashtu, duhen shërbime për target-grupin e fëmijëve me aftësi ndryshe.
- Është shumë e nevojshme prania e një punonjësi social që mund të ofrojë shërbim psikologjik në familje, sidomos tek fëmijët.
- Kërkohet ngritja e një qendre më vete, ku në vëmendje të jenë fëmijët me aftësi të kufizuara dhe sygjerohet për shtim stafi tek njësia e Bregut të Lumit. Duke qenë se qendrat aktualisht janë në varësi të Bashkisë, duhen shtuar më shumë shërbimet.
- Duhet të ofrohen terapi në qendrat që kanë persona me aftësi të kufizuara, pak a shumë si tek qendra "Gonxhe Bojaxhi".
- Mungesa e një qendre ditore për fëmijët autikë sakrifikon punën e njërit prind për të mbajtur fëmijën e tij dhe ky është një problem kryesor për këto familje.
- Njësitë vendore duhet të bëjnë më shumë verifikime në terren, pasi banorët kanë probleme me lidhjen e kontratës së qerasë me pronarët e shtëpisë.
- Kërkohet që të hiqet vërtetimi i shkollës që merret për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe dorëzohet tek njësia çdo tre muaj dhe të gjendet mundësia të merret online.
- Ka problematika në "Pallatin e beqarëve" dhe kërkohet ndërhyrje e ndihmë.

Njësia Administrative Baldushk

- Qytetarët e kësaj njësie bëjnë përsëri kërkesë për të patur 2 veterinerë të cilët mungojnë.
- Fermerët kryesisht janë vetëfinancuar, kanë patur ndihmë nga AZHBR, por nuk kanë bërë aplikime sepse ka shume kriteret që sipas banorëve ata nuk kanë mundësi t'i plotësojnë, konkretisht kërkohet sipërfaqe e madhe e tokës, të jetë me dokument pronësie etj.
- Banorët kërkojnë sistem vaditje dhe treg fruta-perime ku të shiten produktet bujqësore.
- Sipas banorëve, subvencionet nuk kanë funksionuar për këtë zone dhe kërkohet ulje e çmimeve të imputeve bujqësore.
- Ka nevojë për kopsht me drekë fshati Mustafakoç, aktualisht nuk ka asnjë, si dhe një kënd lojrash për fëmijë.
- Kërkohen shërbime rezidenciale për të moshuarit.
- Furnizim me ujë të pijshëm ka e gjithë zona, banorët furnizohen me ujë pusi. Ndryshime apo përmirësime nuk ka patur. Linjat me tubacione janë të vendosura por nuk ka burim të ujit. Kanalizimet e ujërave të zeza kanë probleme në zonën Mustafakoç.
- Nevojitet linjë autobuzi në fshatrat Koçaj, Vesia dhe Kokuja si kërkohet shtim orari për zonën në funksion.

Njësia Administrative Dajt

- Është plotësuar këkesa e bërë për shërbimin veterinar në njësi.
- Fermerët e Dajtit kanë përfituar nga akciza e naftës si dhe i është ofruar asistencë teknike dhe kanë mundur të bëjnë aplikimet e nevojshme. Nga aplikimi në AZHBR, 15 fermerë kanë përfituar akcizë naftë.
- Përsa i përket start-up-eve, megjithëse ka patur iniciativa nga përfaqësuesit e bashkisë për përfshirje të këtyre banorëve, nuk janë gjetur personat e duhur që mund të përfitonin nga kjo mundësi, ndërkohë që, njësia Dajt ka shumë familje me të ardhura të ulëta.
- Nuk është bërë ndonjë studim për të nxjerrë problematikat e banorëve dhe identifikimin e atyre që kanë nevojë të trajtohen me ndihmë ekonomike.
- Problematikë e kësaj njësie është mungesa e shkollave, kopshteve dhe çerdheve. Aktualisht ka 4 kopshte për 13 fshatra, dhe asnjë nga ata nuk është kopsht me drekë.
- Në Lanabregas kopshti ekzistues është mbyllur dhe banorët thonë që ky kopsht duhet të hapet tek "Lagjia e re".
- Banorët vlerësojnë çeljen e ambulancës së re në Lanabregas.
- Po ashtu në Linzë është e nevojshme të ketë një shkollë, ndërkohë që dhe për fshatrat Tujan dhe Tufinë nuk ka një shkollë, teksa vetëm në Tujan janë rreth 36 nxënës të cilët nuk kanë asnjë shkollë.
- Fshati Tujan vuan mungesën e ujit po ashtu nuk është ndërtuar as rruga. Edhe Priska vuan nga mungesa e ujit, duke mos patur kështu asnjë përmirësim që nga 2019a.

- Gjithashtu, një problematikë e cila është trajtuar dhe në emisione televizive, janë bërë dhe protesta e peticione nga banorët, akoma nuk ka marrë zgjidhje, dhe kjo është problematika e ndërtimit të rrugës Linzë – Tufinë, problematikë kjo që prek 120 familje.
- Përsa i përket transportit publik, banorët shprehen së një autobus kalon çdo 45 ose 60 min., por nuk ka stacione të mirëfillta dhe orare të publikuara ose të përcaktuara.

Njësia Administrative Farkë

- Përsa i përket kërkesës për shërbimin veterinar në Njësinë Farkë, zyrtarisht në zyrat e njësisë ekziston një njoftim për një person kontakti, i cili ka lënë vetëm emrin dhe numrin e telefonit por që prezenca fizike e këtij nëpunësi mungon. Sipas banorëve, shërbimet për bagëtitë kryhen nga veterinerë privat, ndërkohë që shërbimi i vaksinave 1 herë në vit është pa pagesë dhe kryhet nga veterineri shtetëror.
- Përsa i përket mbështetjes së fermerëve, atyre i është ofruar asistencë teknike dhe profesionale.
- Aktualisht, në këtë njësi ka vetëm disa kopshte me orar të reduktuar, që janë të vendosura brenda ambjenteve të shkollave. Sipas banorëve është miratuar një projekt për kthimin e një ndërtese në çerdhe-kopsht, por akoma nuk ka avancuar si projekt.
- Njësia Farkë përbëhet nga 12 fshatra dhe ka një popullsi prej rreth 25000 banorë dhe nuk ka asnjë çerdhe dhe asnjë kopsht me drekë. Mungesa e këtyre shërbimeve sjell gjithashtu dhe pamundësinë e fuqizimit ekonomik të grave dhe familjeve, pasi edhe pse ato kanë mundësi të punojnë edhe në qendrat tregtare rrotull njësisë, fakti që nuk kanë ku të lënë fëmijët ua bën të pamundur shfrytëzimin e kësaj mundësie.
- Kërkohet ndërtimi i çerdheve në Farkë, në Lundër dhe në Çollak.
- Problematikat me ujën edhe në Njësinë Administrative Farkë, vijojnë, sidomos në Mjul-Bathore. Uji është me orar, pa përcaktime fikse të orareve dhe i papijshëm. Kanalizimet nuk janë përmirësuar dhe pusetat nuk mirëmbahen. Problematikë është dhe çarja e tubacioneve apo reshjet e shiut, që bëhen shkak për bashkimin e ujrave të bardha me ujrën e zeza.
- Ka amortizim të rëndë të rrugëve, sidomos Rr. “Xixë”, Rr. “Dollash” dhe Rr. “Tufë”. Por edhe projekti i rrugës së “Agallarëve” që është bërë më herët, akoma nuk është zbatuar.
- Problem mjaft aktual mbetet shërbimi urban. Edhe ky shërbim, sipas banorëve nuk ka asnjë përmirësim dhe vazhdon të jetë një penalizim për jetën e banorëve. Në këtë njësi ekziston vetëm një linjë private autobuzi çdo 1 orë. Ka çmim më të lartë por dhe orar të reduktuar. Banorët kërkojnë që linja e tyre të jetë linjë urbane dhe jo interurbane, të njohë shërbimin e abonesë si dhe të zgjasë orarin e shërbimit deri në orën 22:00, pasi aktualisht është deri në orën 19.00. Kërkohet shtim itinerari edhe në Mjul-Bathore dhe TEG, ndërkohë që aktualisht është Terminal-Sauk- Farkë e Vogël – Lundër.

Përfundime dhe Rekomandime

Prioritetet e Kontratës Sociale për Tiranën janë relevante dhe të arsyeshme. Gjatë këtij monitorimi në periudhën Shtator 2020-Shtator 2021 u vu re një angazhim pozitiv nga ana e Bashkisë për të përmbushur disa prej prioriteteve të dala nga qytetarët e Tiranës. Gjithashtu qasja e qytetarëve të Tiranës për t'u bërë pjesë e monitorimit dhe diskutimet në fokus-grupet e realizuara pësoi një rritje të konsiderueshme. Qendra "Aleanca Gjimore për Zhvillim" do të vijojë përsëri monitorimin e punës së Bashkisë, drejtorive përkatëse si edhe vendimeve të Këshillit Bashkiak pranë kësaj Bashkie.

Bashkia Tiranë ka përmbushur rreth 80 % të prioriteteve të Kontratës Sociale të firmosur në Qershor të vitit 2019. Ndaj, është e nevojshme që të merren parasysh prioritetet e dala nga takimet me qytetarët sipas Njësive Administrative, disa prej të cilave po i listojmë si vijon:

- Rishikimi i lagjeve apo Njësive Administrative ku ana infrastrukturore e rrugëve, trotuareve apo sinjalistikave mungon.
- Kthimin e vëmendjes në Njësitë Administrative rurale sa i përket kërkesave të banorëve për ndërtim çerdhesh për fëmijë apo kopshtesh me ushqim.
- Furnizimi me ujë të pijshëm 24 orë nga masa 70 % që është aktualisht të bëhet në masën 100 %.
- Bërja publike me anë të fushatave mediatike apo në terren që nëse uji është i pijshëm, banorët e Tiranës të ndalojnë blerjen e tij.
- Rishikimi i menaxhimit të punës sa i përket kanalizimeve të ujërave të zeza në disa zona të ndryshme të Tiranës.
- Rritje e kërkesës së llogarisë ndaj kompanive të pastrimit të mbetjeve në Tiranë.
- Të rishikohen marrëveshjet e bashkëpunimit me kompanitë e transportit, në mënyrë që shërbimi të ofrohet në orare më të shpeshta dhe me shtim flote, sidomos për Njësitë Administrative rurale.
- Të shikohen me përparësi shqetësimet e ngritura nga komuniteti gjatë takimeve të fundit të realizuara në muajin Shtator 2021.

Referenca

Faqja zyrtare e Bashkisë Tiranë <https://www.tirana.al/>

Faqja zyrtare e Kryetarit të Bashkisë w<https://www.facebook.com/ErionVeliaj>

Faqja zyrtare e Këshillit Bashkiak Tiranë <https://tirana.al/kategori/keshilli-bashkiak>

Kontrata Sociale Tiranë w<https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2020/07/Tirana-Prioritetet-A3-Kontrata.pdf>

Raporti i vitit të parë monitorues të Kontratës Sociale <https://popnetwork.al/raporti-nje-vjecar-kontrata-sociale-bashkia-tirane/>

Takime me komunitetin <https://popnetwork.al/category/aktivitete-tirane/>

Vendime të Këshillit Bashkiak <https://www.vendime.al/category/tirane/2021-tirane/>

Open data: http://spending.data.al/en/treasury/list/year/2019/inst_code/2101001

Anekse

Aneks 1. Kontrata Sociale e detajuar

KONTRATA SOCIALE PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE PRIORITETET E KOMUNITETIT BASHKIA TIRANË

Prioriteti 1: Shërbime veterinare në zonat rurale: Zgjerim i shërbimit veterinar në Njësitë Baldushk, Dajt dhe Farkë.

Prioriteti 2: Nxitja e biznesit të rinjtë, gratë dhe grupet vulnerabël: Zgjerimi i programeve ekzistuese me fokus të rinjtë dhe gratë:

- Informimi i gjerë i grave dhe të rinjve mbi programet për nxitjen e biznesit dhe procesin e aplikimit për t'u përfshirë në këto programe.
- Rritje e buxhetit për start-upe për të rinjtë, i cili rrjedhimisht nënkupton rritje të numrit të përfituesve.
- Zhvillimi i incentivave për nxitjen e biznesit dhe krijimin e vendeve të reja të punës.
- Identifikimi i personave me aftësi të kufizuara, grave kryefamiljare apo vajzave-nëna dhe integrimi përmes këtyre incentivave.

Prioriteti 3: Mbështetja e fermerëve: Zhvillimi i programeve ekonomike që mbështesin fermerët. Njoftimi i tyre nga drejtoritë përkatëse në Njësitë Administrative dhe asistencë teknike dhe profesionale.

Prioriteti 4: Taksat bashkiake: Krijimi i lehtësive për tarifat e taksave bashkiake për kategoritë në nevojë si gra kryefamiljare, invalidët epunës, persona me aftësi ndryshe, vajza-nëna.

Prioriteti 5: Kopshtet dhe çerdhet: Ngritja e kopshteve dhe çerdheve të reja në të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë, por sidomos në zonat rurale, në veçanti i çerdheve në Farkë dhe Dajt ku mungon plotësisht ky shërbim.

Prioriteti 6: Zgjerimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror për individët në nevojë, në njësitë vijuese:

Të gjitha njësitë:

- *Ngritje e shërbimit rezidencial për të moshuarit.*
- *Trajtim me prioritet me strehim social të familjeve që jetojnë në bodrume dhe të grave të dhunuara.*

Njësia 2, 5, 7 dhe Farkë : Ngritja e një qendre komunitare për kategoritë në nevojë.

Njësia 3: Shmangia e vonesave në shpërndarjen e ndihmës ekonomike si dhe mbështetja me më shumë shërbime e familjeve me ndihmë ekonomike, në mënyrë të veçantë përmes strehimit social. Ngritja e një qendre ditore për të moshuarit.

Njësia 7: Zgjidhje afatgjatë e strehimit për banorët që preken nga projekti i Lanës dhe Unazës së Madhe.

Njësitë rurale: Krijimi i aksesit tek shërbimet sociale të ngritura nga Bashkia; Shërbime për moshën e tretë.

Prioriteti 7: Ngritja e shkollave të reja në Njësitë Administrative nr. 1, nr.2 (Në zonën e Depos së Ujit në rrugën “Budi”), nr.3, nr.5, nr.8 (në shkollën “Skënder Çaçi” vijon mësimi me dy turne dhe nga 33 veta në klasë), Baldushk (ka fshatra që janë larg dhe fëmijët e kanë vështirë të shkojnë deri në qendër), Dajt (mungon shkolla e mesme, më e afërta është 1 orë larg). Planifikimi për të rregulluar sistemin e ngrohjes dhe të tualeteve në çdo shkollë 9-vjecare apo të mesme.

Prioriteti 8: Ngritja e bibliotekave të lagjes në Njësitë 1,3 dhe 5 si edhe në zonat rurale.

Prioriteti 9: Zgjerim i programeve ndërgjegjësuese në lidhje me dhunën në familje dhe pasojat e saj. Rritje e identifikimit të rasteve të dhunës në familje përmes punës proaktive në komunitet të strukturave të shërbimeve sociale; Forcimi i rrjetit të policimit në komunitet dhe ndërlihdsave me komunitetin. Zgjerim i shërbimeve ekzistuese mbrojtëse, fuqizuese dhe ri-integruese për viktimat e dhunës në familje.

Prioriteti 10: Adresimi me prioritet i furnizimit me ujë dhe problemeve me kanalizimet për secilën prej njësisive vijuese:

Njësia 1: Zgjidhja e furnizimit me ujë, me prioritet zonat ku uji shkon vetëm 1 herë në ditë. Masa për të shmangur bllokimin e kanalizimeve.

Njësia 2: Prioritet rruga “Budi” ku uji vjen në orën 7 të darkës dhe ka vetëm dy orë. Gjithashtu, uji është i pakonsumueshëm. Zgjidhje për kanalizimet në këtë njësi (erë e padurueshme që vjen si pasojë e kanalizimeve të pa rregulluara.)

Njësia 3: Furnizim me ujë të pijshëm në të gjithë njësinë njësoj si në lagjen “Kodra e Priftit” që furnizohet me ujë pa ndërprerje. Ndërhyrje për kanalizimet veçanërisht në rrugët më problematike “Ali Bahushi”, “Kongresi i Manastrit” dhe “Kujtim Laro”.

Njësia 4: Furnizim pa ndërprerje me ujë të pijshëm dhe përmirësim i cilësisë së ujit. (Aktualisht furnizimi tre herë në ditë, më orare dhe nuk është i përdorshëm për t’u pirë.)

Njësia 5: Ndërhyrje tek Pallatet “Agimi”, në kufi me rrugën “Brigada e 8-të” ku tubacionet e ujit janë të vjetra.

Njësia 7: Furnizim pa ndërprerje me ujë të pijshëm dhe përmirësim i cilësisë së ujit. (Ujin e pijshëm banorët e blejnë.). Zgjidhja e rrjedhjes së ujrave të zeza para konvikteve të “Inxhinierisë së Ndërtimit”, ujëra që zbresin deri tek “Fusha e aviacionit”.

Njësia 8: Furnizim pa ndërprerje me ujë të pijshëm dhe përmirësim i cilësisë së ujit. Ndërhyrje në kanalizimet e rrugës “Ferit Xhajko”. (Pallati 59/8 vuan nga era e

padurueshme që vjen si pasojë e kanalizimeve të pa rregulluara. Problem ekzistues prej 30 vitesh.)

Njësia Baldushk: *Furnizim pa ndërprerje me ujë të pijshëm dhe përmirësim i cilësisë së ujit. (Disa prej banorëve përdorin puset e tyre. Uji që vjen nuk është i pijshëm.)*

Njësia Dajt: *Furnizim pa ndërprerje me ujë të pijshëm dhe përmirësim i cilësisë së ujit. (Nuk ka ujë të vazhdueshëm, vjen me orare, përdoren depozita edhe pse është zona e ujit të burimit, uji bëhet i pa pijshëm. S'ka furnizim 24 orë.)*

Njësia Farkë: *Furnizim pa ndërprerje me ujë të pijshëm dhe përmirësim i cilësisë së ujit me prioritet lagjia "Dina" dhe "Farkë e Vogël". Zgjidhje e problemit të derdhjes së ujërave të zeza në tokat e banorëve.*

Prioriteti 11: *Shtimi i autobuzëve në linjat e Njësive Administrative Baldushk, Dajt dhe Farkë. Publikimi në stacion i orareve të mbërritjes dhe nisjes së autobuzëve.*

Aneks 2 – Gjetjet Kryesore të Raportit të Vitit të Parë Monitorues

Në bazë të monitorimit të Bashkisë Tiranë, të kryer nga Qendra "Alenca Gjinore për Zhvillim" më poshtë renditen disa nga gjetjet kryesore të dala nga ky monitorim për periudhën shtator 2019-shtator 2020.

- Në buxhetin e bashkisë Tiranë ka patur rritje për të rinjtë start-up, nga fondi 2.100.000 lekë me 20 përfitues dhe në fondin 5.000.000 lekë me 20 përfitues;
- Sipas Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, (AZHBR) nga data 29 maj deri 19 qershor 2020, fermerët kanë patur mundësinë të aplikojnë në e-Albania, me zero dokumente, për të përfituar nga fondet që jep buxheti i shtetit si mbështetje për sektorin bujqësor përmes Skemës Kombëtare 2020. Por, sipas takimeve me komunitetin, fermerët kryesisht janë vetfinancuar, nuk kanë bërë aplikime sepse ka shume kriteret që sipas banorëve ata nuk kanë mundësi për ti plotësuar, konkretisht kërkohet sipërfaqe e madhe e tokës, të jetë me dokument pronësie etj;
- Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit "Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë", ka njoftuar në mënyrë të vazhdueshme njësitë e qeverisjes vendore me përcaktimin e funksioneve, detyrave specifike dhe standarteve të shërbimit veterinar, megjithatë në dy prej njësive të zonave rurale komuniteti vijon kërkesën për shtim veterinerësh;
- Në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.58 datë 26.12.2019 nuk janë parashikuar lehtësira për tarifën e taksave bashkiake për kategoritë në nevojë si gra kryefamiljare, apo vajza nëna.
- Gjatë periudhës monitoruese një vjeçare janë bërë disa ndërhyrje sa i përket çerdheve dhe kopshteve për fëmijë me rreth 8 godina të rikonstruara, ndërkohë që në njësitë administrative rurale nuk ka çerdhe dhe kopshtet janë pa ushqim;

- Ngritja dhe funksionimi i shërbimit rezidencial për të moshuar dhe persona që jetojnë në situatë rruge, target grup i vlerësuar si më vulnerabël, realizohet përmes Qendrës Sociale “Strehëza Tiranë”,
- Nga janari në qershor 2020, janë miratuar 2 vendime për përfitim Bonus Qiraje në Këshillin Bashkiak, ku janë shpallur fituese 41 gra,
- Është realizuar Inagurimi i Shërbimit Komunitar Lëvizës, Njësia Administrative Farkë në dhjetor 2019. Bashkia Tiranë në bashkëpunim me SOS Fshatrat në Shqipëri, kanë bashkëmodeluar dhe lancuar fillimin e ofrimit të shërbimeve lëvizëse sa më pranë familjes dhe anëtareve të komunitetit,
- Ndihma Ekonomike është dhënë brenda afatit të caktuar dhe nuk ka patur problematika apo ankesa nga përfituesit.
- Aktualisht, projekti më i ri që bashkia ka në qëllim për zbatim janë Klubet e Prindërimit, përmes të cilit, partnerë dhe ekspertë të fushës nga Save the Children, Terre des hommes, World Vision dhe Bethany Social Services, do të mundësojnë module trajnime për prindërim pozitiv, duke shkuar pranë çdo komuniteti rural.
- Sa i përket shërbimeve për moshën e tretë në zonat rurale, Bashkia Tiranë është në proces të vlerësimit të aseteve të mundshme për të ngritur shërbime komunitare pranë zonave të ndryshme të njësive administrative rurale e në bazë të tyre të projektojnë shërbimet e përshtatshme e planifikojë strukturat enevojshme shërbimofruese.
- Lidhur me prioritetet sipas Kontratës Sociale përsa i përket ndërhyrjeve sipas njësive administrative nr. 1, nr. 2, nr.3, nr. 5 dhe nr. 8, janë kryer 4 tipologji ndërhyrjesh kryesore: Ndërhyrjet me rikonstruksion; Ndërtimet e reja në objektet shkollore; Ndërhyrjet me “Mirëmbajtje të thellë” në tualete; Në sistemin e ngrohjes qëndrore me kaldajë.
- Gjatë vitit të parë, pas firmosjes së Kontratës Sociale POP, nuk është ngritur asnjë bibliotekë e re. Kjo edhe për shkak të situatës së krijuar nga termeti dhe pandemia COVID-19 megjithatë Bashkia e Tiranës ka në fokus shtimin e numrit të bibliotekave.
- Që nga muaji Qershor 2020 përmes investimit të ri për zgjerimin e impiantit Bovillë dhe ndërtimit të linjave të reja të transmetimit është siguruar furnizim 24 orë për më shumë se gjysmën e kryeqytetit, në të cilën përfshihen plotësisht apo edhe pjesërisht disa njësi administrative. Sipas përlllogaritjeve të UKT-së, 62% e popullsisë së kryeqytetit ka aktualisht furnizim 24 orë në 24.
- Një prej prioritetëve të Kontratës Sociale ishte edhe shtimi i numrit të autobusëve sidomos për linjat e njësive administrative rurale Dajt, Baldushk dhe Farkë. Përballja me një situatë aspak të favorshme kjo për shkak të pandemisë COVID-19, ky prioritet nuk është përmbushur akoma.

Aneks 3 – Investimet në shkolla

Në vijim jepet tabela e detajuar me ndërhyrjet, mirëmbajtje e thellë në tualete dhe në sistemin e ngrohjes qendrore me kaldajë, gjithashtu ndërhyrjet me rikonstruksion dhe ndërtimet e reja në objektet shkollore sipas Njësive Administrative të qytetit të Tiranës.

Nr.	Objektet Arsimore në Zonat Urbane të qytetit të Tiranës	Mirëmbajtje e thellë e tualeteve	Mirëmbajtje e thellë e Sistemeve të Ngrohjes Qendrore me Kaldajë	Ndërhyrje të tjera
	Shkolla 9 - vjeçare			1.Punime hidraulike 2. Punime elektrike 3. Punime muratori 4. Punime marangozi
1	Shkolla 9-vjeçare "Androkli Kostallari "			po
2	Shkolla 9 - vjeçare "Marie Logoreci "			po
	Shkolla 9 - vjeçare			po
1	Shkolla 9-vjeçare "Osman Myderizi"		+	po
	Shkolla 9 - vjeçare			po
1	Shkolla 9-vjeçare " Hasan Prishtina "	+		po
2	Shkolla 9-vjeçare "Kongresi i Lushnjës "			po
	Shkolla 9 - vjeçare			po
1	Shkolla 9-vjeçare "Gjon Buzuku"			po
3	Shkolla 9-vjeçare " Bajram Curri "		+	po
	Shkolla të Mesme			po
1	Shkolla e Mesme "Besnik Sykja"			po
	Shkolla 9 - vjeçare			po
1	Shkolla 9-vjeçare "Edith Durham"			po
2	Shkolla 9-vjeçare "26 Nëntori"	+		po
3	Shkolla 9-vjeçare "At Zef Pellumbi "	+		po
	Shkolla 9-vjeçare "Murat Toptani "	+		po
	Shkolla të Mesme			po

1	Shkolla e Mesme " Myslym Keta "	+	+	po
	Shkolla 9 - vjeçare			po
1	Shkolla 9-vjeçare "Kongresi Manastirit "	+		po
	Shkolla 9 - vjeçare			po
1	Shkolla 9-vjeçare "Pjetër Budi "			po
	Shkolla të Mesme			po
1	Shkolla e Mesme "Partizani "			po
	Shkolla 9 - vjeçare			po
1	Shkolla 9-vjeçare "4 Dëshmorët"			po
2	Shkolla 9-vjeçare "Shkolla e Kuqe"			po
	Shkolla të Mesme			po
1	Shkolla "Sami Frashëri"			po
	Shkolla 9 - vjeçare			po
1	Shkolla 9-vjeçare "Lidhja e Prizrenit "		+	po
2	Shkolla 9-vjeçare "Qazim Turdiu "			po
3	Shkolla 9-vjeçare "7 Marsi"			po
	Shkolla 9 - vjeçare			po
1	Shkolla 9-vjeçare "Avni Rustemi"			po
	Shkolla 9 - vjeçare			po
1	Shkolla 9-vjeçare "28Nëntori"		+	po
2	Shkolla 9-vjeçare "Isa Boletini"			po
3	Shkolla 9-vjeçare "Kol Jakova"			po
4	Shkolla 9-vjeçare "Gjergj Fishta"			po